

TATIMI IM, PËR KOMUNËN TIME!

Për komuna më të mira, duke e shlyer në kohë tatimin në pronë



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

A KENI PRONË DHE A KENI AKTVENDIM PËR TATIMIN NË PRONË?

Si obligues të tatimit në pronë janë personat fizik dhe juridik që kanë prone në një komunë të caktuar, e cila ka detyrim ligjor që të përgatis dhe të lëshojë një aktvendim të detajuar të tatimit në pronë.

Nëse zotëroni pronë në një komunë të caktuar, atëherë ju jeni automatikisht obligues tatimor me të drejtë ligjore për aktvendim të tatimit në pronë për pronën tuaj, por edhe detyrim ligjor dhe përgjegjësi personale që të shlyeni tatimin në kohë.

SI KONTRIBUON TATIMI JUAJ MBI PRONËN PËR RRITJEN E KOMUNËS SUAJ?

Duke paguar tatimin rregullisht dhe në kohë, secili prej nesh kontribuon që komuna vazhdimisht të rritet, zhvillohet dhe të modernizohet.

Kur e paguajmë me kohë tatimin mbi pronë, mjetet nga tatimi e mbushin buxhetin komunal, me të cilin realizohen të gjitha projektet e planifikuara publike dhe infrastrukturore. E thënë thjesht, secili prej nesh kontribuon personalisht për zhvillimin e komunës, e cila në të ardhmen do të zbukurohet me:



çerdhe të reja



kënde lojërash të reja



rrugë të reja



ndriçim të ri



shkolla të reja



parqe të reja



projekte ekologjike për përdorim të burimeve të rripërtëritshme të energjisë



projekte për zhvillim industrial

Tatimet mbi pronën kontribuojnë që komuna të ecë përpara, vazhdimisht të rritet dhe zhvillohet, ndërsa kjo më tej nënkupton një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt me mundësi për një jetë më cilësore për ne dhe brezat e ardhshëm.

Më e rëndësishmja nga të gjitha është të informoheni me kohë dhe saktë për të gjitha të drejtat dhe detyrimet tuaja, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komunës lidhur me tatimin tuaj në pronë.

A E DINI SE...

- ▶ norma tatimore e tatimit mbi mbi pronën është proporcionale dhe është nga 0.1 deri 0.2 % e vlerës së tregut të pasurisë së paluajtshme?
- ▶ tatimi mbi pronën, përkatësisht aktvendimi tatimor përgatitet dhe lëshohet në të njëjtin vit kur edhe duhet të shlyhet?
- ▶ vendimi tatimor përmban një përlllogaritje të detajuar për tatimin tuaj në pronë?
- ▶ vendimi tatimor i drejtohet gjithmonë një taksapaguesi (përkatësisht, një personi fizik ose juridik) për tërë pronën?
- ▶ në qoftë se pasuria është në pronësi të më tepër personave, secili prej tyre është obligues tatimor i tatimit mbi pronën, në proporcion me pjesën e pronësisë?
- ▶ taksapaguesi i pronës është një person juridik ose fizik që është shfrytëzues i pronës në rast se pronari është i panjohur ose thjesht nuk është në qashtëm?
- ▶ Obligues tatimor i tatimit na pronë mund të jetë edhe frutgëzuesi i pasurisë në pajtim me ligjin?
- ▶ tatimin mbi pronë mund ta paguani çdo tremujor gjatë vitit të njëjtë kur është lëshuar vendimi?

SI TË SIGUROHENI QË TATIMI JUAJ MBI PRONËN ËSHTË SHLYER ME KOHË?

Ja ca këshilla dhe fakte për t'ju ndihmuar të siguroheni që gjithçka është në rregull me vendimin tuaj tatimor dhe se e keni paguar tatimin në pronë në kohë!

- ▶ Kontrolloni nëse komuna në të cilën zotëroni pronë ka përgatitur dhe dorëzuar aktvendim për tatimin në pronë për pronën tuaj.
- ▶ Kontrolloni saktësinë e informacioneve tuaja personale dhe llogaritjen e detajuar në vendimin tuaj tatimor.
- ▶ Kontrolloni të dhënat tuaja personale, për shembull, adresën tuaj në të cilën i pranoni aktvendimet e tatimit në pronë dhe nëse ka ndryshime të të dhënave, njoftoni administratën komunale.
- ▶ Nëse vëreni se nuk po pranoni aktvendim për tatimin në pronë, kontaktoni administratën komunale për të shmangur pasoja të mëtejshme ligjore.

